

## Vendim nr. 8 datë 18.01.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 18.01.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 31 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** SHOQËRIA “EMS ALBANIAN PORT OPERATOR” SH.P.K.

**OBJEKTI:** Kontrolli i pajtueshmërisë së ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022 “Për miratimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company sh.a. dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Shfuqizimi i neneve 1, 3 dhe 4 të ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022.

Pezullimi i neneve 1, 3 dhe 4 të ligjit nr. 79/2022, datë 24.11.2022.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 45, 49, pika 3, shkronja “e”, 71, pikat 1 e 2

**dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 06.05.2013 mes Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (autoriteti kontraktor) dhe shoqërisë “Ems Shipping & Trading” GmbH (koncesionari) është lidhur kontrata e koncesionit për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit, nëpërmjet së cilës koncesionarit i është dhënë e drejta, në përputhje me kushtet e saj, për menaxhimin, operimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik e adaptimin për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. Operimi i terminalit do të përfshijë ngarkimin dhe shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesa rifuxho, mineral qymyr etj., por edhe të anijeve me ngarkesa të përgjithshme/gjenerale dhe për ngarkesa për projekte sipas rastit. Për sa i përket përpunimit të ngarkesave rifuxho operatori do të bëjë të gjitha përpjekjet për të arritur një shkallë të lartë specializimi, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostove për njësi. Shërbimet që do të ofrohen do të përfshijnë, gjithashtu, edhe aktivitetet e lidhura me to, me anijet dhe ngarkesat, të tilla, si: përpunimi i ngarkesave, depozitimi, magazinimi, lëvizjet ekstra, transporti, spontimi, marrja dhe shpërndarja, përfshirë marrjen e masave për burimet e kërkuara në infrastrukturë, mjete, pajisje, sisteme, praktika, procedura, programe, organizim dhe burime njerëzore në përputhje me praktikat më të mira industriale dhe siç janë specifikuar në termat e referencës (neni 2, pika 2.1.) Sipas pikës 2.2., zona në të cilën shtrihet ky koncesion (kalatat nr. 10 dhe 11 dhe sheshet) përcaktohet sipas vizatimeve dhe hartave bashkëlidhur kontratës dhe përcaktimeve në masterplanin e miratuar me VKM-në nr. 546, datë 28.05.2009. Sipas pikës 2.5. koncesioni sipas kësaj kontrate jepet për një periudhë prej 35 vjetësh. Sipas nenit 16, zgjidhja e kontratës bëhet në rastet e forcës madhore ose për mospërmbushje nga koncesionari ose nga autoriteti kontraktues. Në këto raste, pala tjetër ka

të drejtë t'i drejtohet gjykatës për përcaktimin e shumës së kompensimit ose dëmshpërblimit dhe, sipas nenit 20, mosmarrëveshjet në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Shoqëria “Ems Albanian Port Operator” (EMS APO) sh.p.k., sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar më 04.06.2013, me objekt të aktivitetit menaxhimin, operimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik e adaptimin e Terminalit Lindor të Portit të Durrësit, sipas marrëveshjes koncesionare të lidhur me qeverinë shqiptare.

3. Në datën 14.04.2022 shoqëria “Symphony Real Estate Development” sh.p.k. dhe Këshilli i Ministrave kanë rënë dakord për disa terma dhe kushte thelbësore “në parim” dhe “jo detyruese” që dëshmojnë interesin e tyre të ndërsjellë për zhvillimin e projektit për zhvillimin urban dhe rigjallërimin e një pjese të qytetit të Durrësit, duke përdorur elementet e arkitekturës tradicionale shqiptare, të integruara me arkitekturën bashkëkohore mesdhetare nëpërmjet një rikonceptimi të ri të portit dhe zonës përreth, duke sjellë një bregdet të ri, duke integruar zonën rezidenciale përgjatë vijës bregdetare dhe marinës, si dhe për të orientuar turizmin vendas drejt atij elitare dhe të tjerëve.

4. Me vendimin nr. 14/6, datë 02.12.2021 (*vendimi nr. 14/6*), Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) ka vendosur miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Marina & Jahtet e Durrësit” (Durrës Yachts & Marina), dhe sipas pikës 3 të tij ky projekt do të realizohet nga subjekti aplikues “Symphony Real Estate Development” sh.p.k. Me vendimin nr. 14/45, datë 18.07.2022 të KIS-it janë miratuar disa ndryshime në vendimin nr. 14/6, mes të tjerash, realizimi i projektit nga shoqëria “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k. (ish-“Symphony Real Estate Development” sh.p.k.) dhe garantues financiar shoqëria NSHMI Development L.L.C.

5. Ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe shoqërisë “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k., shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a. dhe shoqërisë NSHMI Development L.L.C. është lidhur marrëveshja kuadër, me qëllim rregullimin dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve në lidhje me zbatimin e projektit, ofrimin e shërbimeve, funksionimin e investitorit strategjik, dhënien e të drejtave të zhvillimit në sheshin e projektit, parimet e drejtimit të biznesit të investitorit strategjik, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve (pika 3.1.).

---

Vendim i Kolegjit

Kërkuuese: shoqëria “Ems Albanian Port Operator” sh.p.k.

6. Me ligjin nr. 79/2022, datë 24.11.2022 (*ligji nr. 79/2022*), Kuvendi i Shqipërisë, në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 dhe 2 dhe 155 të Kushtetutës, ka miratuar marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company sh.a. dhe NSHMI Development L.L.C. për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje kuadër sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji (neni 1). Sipas nenit 2 (regjimi i posaçëm në zbatim të marrëveshjes), dhënia e lejeve, licencave dhe akteve të tjera administrative të nevojshme për realizimin e projektit bëhet sipas legjislacionit në fuqi dhe pronat e paluajtshme shtetërore të transferuara në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti i kalojnë në pronësi me VKM shoqërisë “Albanian Seaports Development Company” sh.a. Neni 3 i ligjit (miratimi i statutit të shoqërisë së përbashkët) parashikon se kushtet thelbësore që duhet të përmbajë statuti i shoqërisë së përbashkët janë sipas shtojcës 8 të ligjit, kurse sipas nenit 4 (miratimi i marrëveshjeve), shoqëria “Albanian Seaports Development Company” sh.a. lidh marrëveshjen e zhvillimit dhe kontratën për transferimin e titullit të pronësisë sipas tekstit të dokumenteve bashkëlidhur këtij ligji, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lidh marrëveshjen “Për Marinën e Durrësit” sipas tekstit të dokumentit bashkëlidhur këtij ligji. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 173, datë 22.12.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

7. Në datën 05.05.2023 shoqëritë “Ems Albanian Port Operator” sh.p.k. dhe “Ems Shipping & Trading” GmbH i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues, duke kërkuar shfuqizimin e neneve 1, 3 dhe 4 të ligjit nr. 79/2022, si dhe pezullimin e tyre deri në dhënien e vendimit nga Gjykata.

8. Me vendimin nr. 179, datë 18.07.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se kërkuueset nuk arritën të provojnë interesin e tyre për t`iu drejtuar Gjykatës.

9. Me kërkesën e datës 30.11.2023 kërkuësja shoqëria “Ems Albanian Port Operator” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt.

## II

### Pretendimet e kërkueses

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se:

---

Vendim i Kolegjit

Kërkuese: shoqëria “Ems Albanian Port Operator” sh.p.k.

*A) Për pezullimin e zbatimit të neneve 1, 3 dhe 4 të ligjit nr. 79/2022:*

10.1. Dispozitat e kundërshtuara të ligjit dhe zbatimi i marrëveshjes kuadër dhe anekseve të saj cenojnë drejtpërdrejt veprimtarinë ekonomike të kërkueses. Ndërsa shqyrtimi kushtetues kërkon kohën e tij, dinamika e veprimtarisë ekonomike të kërkueses mund të precipitojë shumë shpejt për shkak të avancimit në implementimin e projektit sipas marrëveshjes kuadër që mbivendoset me kontratën e koncesionit.

*B) Për themelin e pretendimeve kërkuësja pretendon se dispozitat e kundërshtuara cenojnë:*

10.2. *Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)*, pasi ato autorizojnë disponimin e pasurive publike a shtetërore dhe dhënien e kontratave publike duke përjashtuar procedurat ligjore konkurruese. Parimet e MSA-së, të marra përsipër edhe nga shteti shqiptar, reflektohen në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, ligjin për prokurimet dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tyre, legjislacionin në thelb të të cilit qëndron përzgjedhja në përputhje me parimet e konkurrencës, transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe sigurisë ligjore.

10.3. Përjashtimi nga procedurat konkurruese që autorizon ligji nr. 79/2022 i referohet marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj të Emirateve të Bashkuara Arabe, të ratifikuar me ligjin nr. 145/2020, neni 6 i së cilës duket se përjashton projektin për rihvillimin e Portit të Durrësit nga procedurat konkurruese. Neni 6 i marrëveshjes për bashkëpunim diskriminon investitorët vendas dhe ata të komuniteteve evropiane e shteteve anëtare, të cilët respektojnë parimet e gjithëpranuara të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës, që garantohen nga procedura konkurruese, ndërsa investitorët e Emirateve të Bashkuara Arabe i vendos mbi këto parime dhe ata përfitojnë kontrata publike pa iu nënshtruar procedurave përzgjedhëse konkurruese. Ndaj përpara Gjykatës shtrohet çështja nëse duhet të zbatohen dispozitat e Kushtetutës dhe të MSA-së apo neni 6 i marrëveshjes për bashkëpunim ekonomik. Referuar Konventës së Vjenës Gjykata nuk duhet ta marrë në konsideratë si të zbatueshme marrëveshjen, të lidhur dhe të ratifikuar pas hyrjes në fuqi të MSA-së, për aq sa vjen në kundërshtim me këtë të fundit.

10.4. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe parimin e barazisë përpara ligjit*, të parashikuara nga nenet 11 dhe 18 të Kushtetutës. Duke miratuar marrëveshjen kuadër dhe anekset e saj, që disponojnë pasuri shtetërore dhe/ose publike dhe japin të drejta nëpërmjet kontratave publike, në përjashtim nga procedurat konkurruese, ligji devijon nga parimet kushtetuese që sanksionojnë këto dispozita. Ai ka autorizuar disponimin për Portin Detar të Durrësit dhe bregun e detit, të cilat janë pasuri publike dhe/ose shtetërore, nëpërmjet kontratave publike në favor të një a më shumë subjekteve private, duke i hequr mundësinë çdo subjekti tjetër privat të konkurrojë duke paraqitur ofertë për t'u vlerësuar në kuadrin e përzgjedhjes së fituesit për realizimin e projektit. Për shkak të këtij ligji ndjekja e procedurave konkurruese për disponimin e Portit të Durrësit dhe bregdetin e tij nuk është e mundur.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuësja, së bashku me shoqërinë tjetër “Ems Shipping & Trading” GmbH, i është drejtuar edhe më parë Gjykatës me kërkesë me të njëjtin objekt, për të cilën, me vendimin nr. 179, datë 18.07.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare pasi vlerësoi se kërkuëset nuk legjitimohen *ratione personae* sepse nuk kanë

arritur të provojnë interesat e tyre konkrete dhe të drejtpërdrejta që janë prekur nga ligji nr. 79/2022.

13. Në lidhje me atë kërkesë, Kolegji, duke analizuar faktet me natyrë kushtetuese, me qëllim verifikimin e plotësisimit të kriterëve të legjitimitimit nga kërkueset, ka vlerësuar se referuar përmbajtjes së kontratës koncesionare, e cila ka përcaktuar objektin dhe fushën e veprimtarisë, si dhe referuar përmbajtjes së ligjit të kundërshtuar, kërkueset, edhe pse kanë barrën e provës në këtë drejtim, nuk kanë arritur të provojnë se si preken në mënyrë të drejtpërdrejtë në ushtrimin e veprimtarisë për menaxhimin, operimin, ndërtimin, mirëmbajtjen, përmirësimin teknik dhe adaptimin për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit. Ato nuk kanë parashtruar asnjë argument në lidhje me pasojat konkrete që kanë ardhur në kontratën e koncesionit, pra në drejtim të vlefshmërisë dhe kohëzgjatjes së saj dhe nuk kanë pretenduar se kontrata ka përfunduar në mënyrë të njëanshme nga ana e autoritetit kontraktues apo se ka ardhur ndonjë pasojë tjetër në këtë marrëdhënie. Nga shteti nuk janë ndërmarrë ende veprime juridike dhe faktike, si dhe nuk ka pasur njoftime për prishjen e kontratës. Vetëm kur këto veprime të ndërmerren do të lindin pasoja konkrete për interesat e kërkueseve. Nga ana tjetër, për të gjitha të drejtat që kanë lindur dhe janë ushtruar nga kërkueset në bazë të kontratës së koncesionit, ato kanë të drejtën të kërkojnë mbrojtjen ligjore që ofron legjislacioni në fuqi, si dhe parashikimet e kësaj kontrate në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Vetëm fakti se ato ushtrojnë një veprimtari të caktuar në një zonë e cila është vendosur t'i jepet për zhvillim një subjekti të caktuar, nuk i legjitimon ato në nivel kushtetues, për sa kohë që kanë mjete të tjera ligjore në dispozicion të ofruara nga legjislacioni i zakonshëm (*shih paragrafët 15 dhe 16 të vendimit nr. 179, datë 18.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës*).

14. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e çështjes së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ai argumenton një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e pretenduar (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, një prej kriterëve që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Ky rregull ligjor synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës nga të njëjtët kërkues, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime.

Në këto lloj rastesh merr rëndësi të analizohet thelbi i kërkesës, me qëllim për të evidentuar nëse ajo përmban ndonjë informacion, fakt ose rrethanë të re që nuk është shqyrtuar më parë nga Gjykata. Megjithatë, jo çdo fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të Gjykatës ka rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj, në kuptimin që kërkesa e re të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

15. Kërkuesja, në kërkesën në shqyrtim, ka pretenduar se pas dhënies së vendimit nr. 179, datë 18.07.2023 nga Kolegji i Gjykatës, konkretisht në datat 28 dhe 29 korrik 2023, shteti ka ndërmarrë veprime faktike nëpërmjet Autoritetit Portual Durrës (APD), duke rimarrë pjesë nga zonat koncesionare që ishin në përdorim sipas kontratës së koncesionit. Këto veprime kanë cenuar dhe vazhdojnë të cenojnë interesat dhe të drejtat kushtetuese të kërkuases. Kjo është konsideruar për kërkuesen edhe data nga e cila është konstatuar cenimi dhe fillon të ecë afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues. Për të mbështetur pretendimet e saj ajo ka paraqitur disa pamje filmike që i përkasin zonës së Portit të Durrësit, si dhe shkresën nr. 2204 prot., datë 28.07.2023 të APD-së, drejtuar disa operatorëve ekonomikë, përfshirë kërkuesen, për ndryshimin e planit të administrimit të tokës, si dhe për marrjen e masave për implementimin e tij, i cili sipas ligjit është një dokument detyrues.

16. Pavarësisht se kërkuësja ka paraqitur disa rrethana të reja që, sipas saj, justifikojnë tashmë interesin për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, Kolegji vlerëson se, në thelb, edhe kjo kërkesë bazohet mbi të njëjtat shkaqe dhe argumente mbi të cilat është bazuar edhe kërkesa e mëparshme e shqyrtuar nga kjo Gjykatë. Kërkuësja nuk ka sjellë prova në drejtim të pasojave të drejtpërdrejta që kanë sjellë dispozitat e kundërshtuara në lidhje me kontratën e koncesionit, pra për sa i përket vlefshmërisë së saj dhe të drejtave dhe detyrimeve të lindura për kërkuesen. Shkresa e datës 28.07.2023 e APD-së, edhe pse i drejtohet edhe kërkuases, përbën njoftim për ndryshimet në planin e administrimit të tokës brenda Portit Durrës, ndryshime që janë bërë për të garantuar elementet e sigurisë portuale në këtë territor. Këto ndryshime kanë të bëjnë me: zgjerim të terminalit të kontenierëve në raport me terminalin e mallrave gjeneralë, për arsye të volumeve të larta të përpunimit; përmirësim dhe zgjerim të planit të hyrjes dhe daljes në terminale për të krijuar më shumë siguri dhe rrjedhshmëri në lëvizjen e mjeteve të transportit; përmirësim dhe ndryshim të akseseve dhe përshtatje të perimetrit rrethues në terminale dhe në portin në tërësi. Ndërkohë, kjo shkresë (njoftim) nuk shprehet për prishjen apo ndryshime që kanë të bëjnë me kontratat e lidhura me këta operatorë ekonomikë, pra as për kontratën e



koncesionit të kërkueses. Kolegji vlerëson se ligji i kundërshtuar zbatohet përmes akteve nënligjore dhe në bazë të tij dalin nga autoritetet zbatuese edhe akte individuale që përcaktojnë edhe pasojat konkrete dhe të drejtpërdrejta për palët. Nga ana tjetër, nga kontrata e koncesionit, që është edhe ligji i zbatueshëm mes palëve, lindin të drejta dhe detyrime për secilën prej tyre, që sjellin edhe pasoja ligjore në rast të mosrespektimit. Kërkuësja ka zgjedhur si rrugë ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara të cenuara ankimin kushtetues individual, ndërkohë që nuk ka provuar se mjetet e tjera ligjore që i lindin nga të drejtat sipas kontratës së koncesionit kanë rezultuar të pasuksesshme ose edhe në rast se do të ushtrohen ato janë jo efektive.

17. Kolegji vëren, gjithashtu, se edhe në kërkesën në shqyrtim kërkuësja i ka fokusuar pretendimet e saj në drejtim të mungesës së konkurrencës së lirë dhe përmbajtjes diskriminuese të nenit 6 të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ekonomik ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe asaj të Emirateve të Bashkuara, të ratifikuar me ligjin nr. 145/2020, pretendime që nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues, pasi kanë të bëjnë me përmbajtjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare pas ratifikimit të saj.

18. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.